



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË
PERFORMANCËS SË SISTEMIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR
2024**



Drejtoria e Performancës

Raporti i Vlerësimit të Performancës së SAPU - 2024

HYRJE

Vizioni i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) për sektorin e arsimit është një sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Në funksion të këtij procesi, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 (SKA) është në harmoni me objektivat e kornizës evropiane për fushën e arsimit dhe formimit, me Kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe me Objektivin 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Vizioni i MAS-it bazohet në realizimin e tre qëllimeve kryesore të politikave:

Qëllimi i Politikës A: Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

Qëllimi i Politikës B: Menaxhim efektiv dhe eficient i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Qëllimi i politikës A lidhet me arsimin parauniversitar dhe zbërthehet në 5 objektiva specifikë:

Objektivi specifik A1: Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë.

Objektivi specifik A2: Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Objektivi specifik A3: Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie.

Objektivi specifik A4: Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë.

Objektivi specifik A5: Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.

Qëllimi i politikës B lidhet me menaxhimin e sistemit të arsimit dhe zbërthehet në 2 objektiva specifikë:

Objektivi specifik B1: Rritja e performancës së shkollës nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional e të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë.

Objektivi specifik B2: Garantimi i performancës së sistemit të arsimit nëpërmjet ndërtimit të një kornize gjithëpërfshirëse të vlerësimit dhe kapaciteteve për zbatimin e saj.

Roli udhëheqës në zbatimin e SKA-së i takon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si institucion përgjegjës për fushën e arsimit. Përgjegjësia institucionale për të realizuar vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar i është ngarkuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është e përcaktuar në Planin e Veprimit dhe ndahet ndërmjet MAS-it, institucioneve vartëse, institucioneve arsimore, vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- 1.1. Qëllimi i vlerësimit
- 1.2. Metodologjia e vlerësimit
- 1.3. Kriteret e vlerësimit
- 1.4. Institucionet përgjegjëse/kontribuese

2. KONTEKSTI I VLERËSIMIT

- 2.1. Kuadri ligjor
- 2.2. Kuadri institucional
- 2.3. Gjendja e sistemit
- 2.4. Përmirësime në sistemin arsimor parauniversitar
- 2.5. Rezultatet e nxënësve në testet ndërkombëtare

3. VLERËSIMI PËRGJITHSHËM

- 3.1. Vlerësimi i performancës së SAPU
- 3.2. Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikave
- 3.3. Vlerësimi i realizimit të objektivave

4. VLERËSIMI TEKNIK I REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE

- A.1. Aksesimi në arsim
- A.2. Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës
- A.3. Mësuesit
- A.4. Zotërimi i kompetencave të nxënësit
- A.5. Digjitalizimi i arsimit
- B.1. Niveli i shkollës
- B.2. Niveli i sistemit

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME SPECIFIKE

6. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

7. ANEKSE

- Aneksi 1. Tabela përmbledhëse e vlerësimit të performancës së sistemit
- Aneksi 2. Korniza e vlerësimit të performancës
- Aneksi 3. Teknika e vlerësimit

SHKURTIMET

ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DPAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (sot AKAP)
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
INSTAT	Instituti i Statistikave
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
NJMF	Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PBA	Programi buxhetor afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PKAB	Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar
SAPU	Sistemi Arsimor Parauniversitar
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
VANAF	Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. QËLLIMI I VLERËSIMIT

Qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së SAPU-së janë:

- a. Nxitja e llogaridhënies së aktorëve të sistemit arsimor, për përmbushjen e objektivave në funksion të qëllimit të politikave.
- b. Përmirësimi i politikave arsimore dhe rritja e rezultateve të sistemit, nëpërmjet shfrytëzimit të informacionit të saktë për gjendjen e sistemit.

1.2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Për vlerësimin e arritjeve të synuara në objektivat e SKA-së, ndiqen hapat e mëposhtëm:

1.2.1. Planifikimi i vlerësimit

Planifikimi është procesi ku përcaktohen objektivi, mënyra dhe koha e planifikimit, si dhe planifikimi i aspekteve kryesore të vlerësimit.

1.2.2. Metodat e mbledhjes së të dhënave

Për grumbullimin e të dhënave përdoren metodat e mëposhtme:

- Të dhënat zyrtare online
- Të dhënat me kërkesë zyrtare
- Të dhëna nga raportet, testimet dhe programet ndërkombëtare
- Monitorimi i drejtpërdrejtë/Intervistimi

1.2.3. Kriteret e vlerësimit

Në dokumentet e vlerësimit të performancës, janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e performancës: kriteri ligjor, kriteri profesional, kriteri financiar dhe kriteri menaxherial.

1.2.4. Nivelet e vlerësimit

Korniza e Vlerësimit të Performancës përcakton pesë nivele vlerësimi 1-5, sipas përqindjeve të rezultatit të arritur.

1.2.5. Kronologjia e vlerësimit

Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar është realizuar në mënyrë të përshkallëzuar, nga poshtë lart, duke filluar me nivelin e realizimit të treguesve, që përcaktojnë nivelin e realizimit të masave dhe duke vijuar me nivelin e realizimit të produkteve, objektivave dhe qëllimit të politikave.

Për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor ndiqet radha e mëposhtme:

- Treguesi
- Masa
- Produkti
- Objektivi

- Qëllimi i politikës
- Performanca e sistemit

1.3. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret për Vlerësimin e Performancës, janë të përcaktuara në Manualin e Vlerësimit të Performancës. Për të vlerësuar nivelin e plotësimit të kriterëve veprohet, si më poshtë:

1.3.1. Kriteri ligjor

Vlerësohet niveli i plotësimit të kuadrit ligjor, në funksion të arritjes së objektivave strategjike.

1.3.2. Kriteri profesional

Vlerësohet kapaciteti i burimeve njerëzore dhe strukturave të nevojshme, në funksion të arritjes së objektivave strategjike.

1.3.3. Kriteri financiar

Vlerësohet niveli i sigurimit dhe përdorimit të burimeve financiare të parashikuara për arritjen e objektivave strategjike.

1.3.4. Kriteri menaxherial

Vlerësohet ecuria e realizimit të masave/produkteve/objektivave, në funksion të arritjes së qëllimit të politikave të SKA-së.

1.3.5. Kriteri i inovacionit dhe teknologjisë


Vlerësohet niveli i aplikimit të teknologjive të reja dhe nismave inovative për përmirësimin e shërbimeve dhe proceseve në sistemin arsimor parauniversitar.

1.4. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ KONTRIBUESE

1.4.1. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgjegjësinë për zhvillimin e sistemit arsimor në Shqipëri. Ajo ushtron këtë rol nëpërmjet strukturave të saj, në qendër dhe në bazë, si dhe nëpërmjet institucioneve të varësisë.

1.4.2. Institucioni përgjegjës për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, është Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), bazuar në VKM nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.

1.4.3. Institucionet kontribuese janë Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilat janë përgjegjës ose kontribuues në realizimin e masave të përcaktuara në SKA dhe dërgimin e të dhënave pranë ASCAP-it.



2. KONTEKSTI I VLERËSIMIT

Më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë e teknologjikë me ndikim në zhvillimet në fushën e arsimit.

2.1. KUADRI LIGJOR

- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.
- VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
VKM nr.129, datë 06.03.2024 “Për disa ndryshime në VKM nr.99, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”” (ndryshon emërtimi nga DPAP në AKAP).
Urdhri nr. 144, datë 01.08.2024 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKAP-it dhe DRAP-eve.”.
Urdhri nr. 571, datë 18.11.2024 i MAS-it “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ZVAP-ve”.
- VKM nr. 540, datë 19.9.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre”.
- VKM nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- Urdhri nr.130, datë 16.03.2022 “Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës në Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe Manualit të saj”
- Urdhri nr.172, datë 3.4.2023 “Për miratimin e raportit për përcaktimin e paketës së treguesve kombëtar të vlerësimit të sistemit arsimor”.

2.2. KUADRI INSTITUCIONAL

Sistemi arsimor në Republikën e Shqipërisë përfshin pesë nivele kryesore:

- Arsimi parashkollor, mosha 3-6 vjeç.
- Arsimi fillor, mosha 6-10 vjeç.
- Arsimi i mesëm i ulët, mosha 11-14 vjeç.
- Arsimi i mesëm i lartë, mosha 15-18 vjeç.
- Arsimi i lartë, mosha mbi 18 vjeç.

2.2.1. Struktura qeverisëse

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Republika e Shqipërisë praktikon një qeverisje të centralizuar të sistemit arsimor. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) është përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, ndërsa arsimi dhe formimi profesional janë kompetencë e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

2.2.2. Njësitë zbatuese të arsimit parauniversitar

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

ASCAP-i është përgjegjës për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor, hartimin e kurrikulës dhe zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

AKAP-i ka 5 drejtori rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) Tiranë, Lezhë, Durrës, Korçë dhe Fier, si dhe 51 zyra vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP). AKAP-i dhe strukturat e varësisë janë përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndër të tjera: monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin; planifikimin e buxhetit të shkollave; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore; zbatimin e kurrikulës dhe standardeve; ofrimin e asistencës teknike në shkolla, punësimin e mësuesve dhe bashkërendimin me autoritetet vendore.

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)

QSHA-ja është përgjegjëse për zhvillimin, administrimin dhe analizën e rezultateve të testeve kombëtare e ndërkombëtare. Në veçanti, QSHA-ja është përgjegjëse për maturën shtetërore, zhvillimin e provimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, provimet e shtetit për profesionet e rregulluara, si dhe administron bazën e të dhënave shtetërore për arsimin.

Shkolla e Drejtorëve

Shkolla është krijuar si organizatë jofitimprurëse dhe funksionon me mbështetjen e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).

2.3. GJENDJA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Tabela 1. Numri i institucioneve në AP për vitin shkollor 2023-2024

NUMRI I INSTITUCIONEVE NË ARSIMIN PUBLIK DHE PRIVAT				
Viti	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Gjithsej
2023 - 2024	2069	1127	452	3648

Tabela 2. Institucionet e arsimit parauniversitar publik dhe privat, 2023-2024

Institucione arsimore 2023-2024	Total	Publik	Privat
Gjithsej	3648	3211	437
Kopshte	2069	1843	226
Arsimi bazë	1127	1014	113
Gjimnaze + Shkolla të arsimit të mesëm të orientuar	448	350	98
Gjimnaze me kohë të pjesshme	4	4	0

Të dhënat statistikore të vitit shkollor 2023-2024 ofrojnë një panoramë të qartë, të strukturuar mbi shpërndarjen e institucioneve arsimore në nivelin parauniversitar në Shqipëri. Bazuar në statistikat zyrtare të publikuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, gjatë këtij viti shkollor funksionojnë gjithsej 3648 institucione arsimore, të cilat shpërndahen në mënyrë të balancuar në tri nivele të arsimit parauniversitar.

- **Arsimi Parashkollor:** Në nivelin e arsimit parashkollor janë gjithsej **2069 institucione arsimore** funksionale. Arsimi i hershëm përfaqëson një shtyllë themelore të politikave arsimore në vend, duke ofruar kushte të përshtatshme për zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve në moshë të vogël. Ky tregues vërteton orientimin e Shqipërisë drejt standardeve evropiane të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (ECEC).
- **Arsimi Bazë:** Në nivelin e arsimit bazë janë gjithsej **1127 institucione arsimore**, të cilat garantojnë ofrimin e një edukimi gjithëpërfshirës dhe cilësor në ciklin fillor dhe të mesëm të ulët. Ky nivel përfaqëson themelin e formimit të njohurive bazë dhe kompetencave kyçe për qytetarinë aktive dhe zhvillimin personal.
- **Arsimi i Mesëm:** Në nivelin e arsimit të mesëm janë gjithsej **452 institucione arsimore**. Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional (ku përfshihen dhe 4 gjimnazet me kohë të pjesëshme), siguron mundësi të larmishme për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe integrim në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e ekonomisë moderne dhe të një shoqërie dinamike të dijes.

Kjo shpërndarje e institucioneve arsimore pasqyron jo vetëm dimensionin gjeografik të shërbimit publik arsimor, por edhe angazhimin për të siguruar gjithëpërfshirje një në arsim cilësor, në

përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe proceset e integritit evropian. Politikat e ndjekura në këtë drejtim janë në linjë me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, duke promovuar standarde të larta në ofrimin e shërbimit arsimor dhe forcimin e mekanizmave të cilësisë dhe llogaridhënies në arsim.

Tabela 3. Numri i nxënësve për vitin shkollor 2023-2024

NUMRI I NXËNËSVE NË ARSIMIN PUBLIK DHE PRIVAT				
VITI	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Gjithsej
2023 - 2024	66711	258072	75348	400131

Sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit shkollor 2023-2024, ka përfshirë në strukturat e tij gjithsej 400.131 nxënës, të shpërndarë në tri nivele të arsimit parauniversitar: në arsimin parashkollor, në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm. Ky tregues përbën një pasqyrë të rëndësishme të kapacitetit përthithës të sistemit arsimor, duke reflektuar një angazhim të qëndrueshëm për përfshirjen dhe arsimimin gjithëpërfshirës të brezave të rinj në të gjitha nivelet e arsimit.

▪ **Arsimi parashkollor - Investim në themelet e hershme të edukimit**

Gjatë këtij viti shkollor, në institucionet e edukimit parashkollor janë regjistruar **66711 nxënës**, një tregues që dëshmon për rritjen graduale të ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme. Kjo rritje pasqyron gjithashtu përpjekjet e qëndrueshme të institucioneve publike dhe partnereve të zhvillimit, për të nxitur gjithëpërfshirjen dhe barazinë në qasjen ndaj edukimit që në hapat e parë të formimit të individit.

▪ **Arsimi bazë - Kolona e formimit të përgjithshëm të nxënësve**

Në arsimin bazë, që përbën strukturën më të gjerë dhe themelin e detyrueshëm të sistemit arsimor parauniversitar, janë të regjistruara **258072 nxënës**. Ky nivel jo vetëm siguron përvetësimin e njohurive bazë në lëndët e formimit të përgjithshëm, por gjithashtu është një instrument kyç për zhvillimin e kompetencave qytetare, shoqërore dhe digjitale të nevojshme për jetën moderne.

▪ **Arsimi i mesëm - Etapë për përgatitje akademike dhe profesionale**

Në arsimin e mesëm janë regjistruar gjithsej **75348 nxënës**, të shpërndarë në programe të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe të mesëm profesional. Ky nivel luan një rol të pazëvendësueshëm në orientimin e të rinjve drejt edukimit të mëtejshëm universitar ose drejt integritit të suksesshëm në tregun e punës. Shifrat përkatëse tregojnë për një stabilitet në interesin e të rinjve për të vazhduar studimet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm, si dhe për potencialin e zhvillimit të mëtejshëm të arsimit profesional në përputhje me nevojat e ekonomisë kombëtare.

Tabela 4. Numri i mësuesve sipas niveleve, 2023-2024

NUMRI I MËSUESVE NË ARSIMIN PUBLIK DHE PRIVAT				
VITI	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Gjithsej
2023 - 2024	5314	24109	6898	36321

Tabela 5. Mësues në arsimin parauniversitar publik dhe privat sipas niveleve, 2023-2024

Mësues 2023 - 2024	Total	Publik	Privat
Institucionet arsimore	36321	31396	4925
Kopshte	5314	4380	934
Arsimi bazë	24109	21502	2607
Arsimi fillor	9336	8182	1154
Arsimi i mesëm i ulët	14773	13320	1453
AML + Gjimnaze të orientuara	6898	5514	1384

Në kuadër të analizës së burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024, evidentohet se numri total i mësuesve të angazhuar në institucionet arsimore publike dhe jopublike në nivel kombëtar është 36321 mësues. Kjo trupë, e shpërndarë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, përfaqëson themelin e funksionimit të qëndrueshëm të procesit edukativo-arsimor, duke kontribuar në mënyrë të përditshme në garantimin e cilësisë, edukimin, zhvillimin e brezit të ri dhe akses të barabartë në arsim për të gjithë nxënësit në mbarë vendin. Ky kontingjent profesionistësh mbulon procesin mësimor në tre nivelet përkatëse të arsimit parauniversitar si më poshtë:

- **Niveli i Arsimit Parashkollor:** Në institucionet e edukimit të hershëm (kopshte publike dhe jopublike), janë të punësuar gjithsej 5314 edukatorë, të cilët ofrojnë kujdesin dhe formimin për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Ky staf përfaqëson një hallkë të rëndësishme në ndërtimin e bazave të qëndrueshme të arsimit fillestar.
- **Niveli i Arsimit Bazë:** Në ciklin nëntëvjeçar (klasa I–IX), përfshirë ciklin fillor dhe atë të mesëm të ulët, janë të angazhuar 24109 mësues. Ky nivel përbën pjesën më të madhe të stafit arsimor në vend, duke qenë i orientuar drejt zhvillimit bazik të njohurive, kompetencave dhe aftësive të përgjithshme të nxënësve gjatë periudhës së detyrimit shkollor.
- **Niveli i Arsimit të Mesëm të Lartë:** Në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale (klasa X–XII), numri i mësuesve të angazhuar rezulton 6898. Ky staf mbulon kurrikulat akademike dhe tekniko-profesionale, duke kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e nxënësve për arsimin e lartë dhe/ose tregun e punës.

Tabela 6. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, përgjatë një harku kohor 3-vjeçar

Numri i nxënësve me AK				
Viti	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Gjithsej
2021 - 2022	502	3724	560	4786
2022 - 2023	510	3707	500	4717
2023 - 2024	600	3887	538	5025

Sipas të dhënave të mbledhura nga institucionet arsimore dhe raportimet periodike të autoriteteve përkatëse, numri i nxënësve me AK ka shënuar një trend rritës nga viti në vit.

Ky fakt tregon për:

- një përmirësim të ndjeshëm të mekanizmave të identifikimit dhe referimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe prindërve mbi të drejtën e fëmijëve për arsim të barabartë;
- avancimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale, që mbështet përfshirjen e këtyre fëmijëve në sistemin arsimor të rregullt.

Tabela 7. Numri i mësuesve ndihmës, përgjatë një harku kohor 3-vjeçar


Numri i mësuesve ndihmës				
Viti	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Gjithsej
2021 - 2022	177	1276	62	1515
2022 - 2023	242	1562	98	1902
2023 - 2024	335	1705	147	2187

Mësuesit ndihmës/ Shtimi i numrit të mësuesve ndihmës

Në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës, përfshirja dhe integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara (AK) në institucionet arsimore publike ka njohur një zhvillim të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm gjatë periudhës 2021-2024. Në zbatim të politikave arsimore, është realizuar një rritje e konsiderueshme e numrit të mësuesve ndihmës të angazhuar për mbështetjen individuale të nxënësve me AK brenda institucioneve arsimore. Ky zhvillim është tregues i një orientimi të politikëbërjes arsimore drejt forcimit të komponentit mbështetës, në funksion të zbatimit të parimit të barazisë në arsim. Krijimi dhe konsolidimi i këtij kontigjenti profesionistësh shënon një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të rolit të mësuesit ndihmës, si një hallkë e domosdoshme në zinxhirin e përmbushjes së nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Tabela 8. Raporti: Numri i nxënësve me AK/ Numri i mësuesve ndihmës

Viti	Numri i nxënësve me AK	Numri i mësuesve ndihmës	RAPORTI
2021 - 2022	4786	1515	3.1
2022 - 2023	4717	1902	2.5
2023 - 2024	5025	2187	2.3



Raporti ndërmjet numrit të mësuesve ndihmës dhe nxënësve me AK paraqet një tregues të cilësisë së mbështetjes së ofruar dhe të shkallës së përqendrimit të burimeve njerëzore për këtë kategori. Nga analiza e të dhënave rezulton si më poshtë:


- Në vitin shkollor 2021-2022, raporti ishte: 1 mësues ndihmës për çdo 3.1 nxënës me AK.
- Në vitin shkollor 2023-2024, raporti është përmirësuar ndjeshëm në: 1 mësues ndihmës për çdo 2.3 nxënës me AK.

Ky ndryshim përfaqëson një rritje të ndjeshme në intensitetin e mbështetjes individuale për nxënësit, duke mundësuar një shërbim më të afërt, më të personalizuar dhe më efektiv. Kjo tendencë përputhet me praktikatat më të mira ndërkombëtare për sigurimin e arsimit të përshtatshëm për nxënësit me nevoja të veçanta, në një ambient të hapur, jo-diskriminues dhe të përshtatur me kapacitetet e secilit individ.

Nga vlerësimi i kësaj dinamike dallohet qartë se ka një vullnet politik të qëndrueshëm për forcimin e arsimit gjithëpërfshirës, përmes alokimit më të mirë të burimeve njerëzore dhe rritjes së cilësisë së mbështetjes së drejtpërdrejtë në shkollë.

Tabela 9. Të dhëna mbi numrin e klasave kolektive

Viti	Klasa kolektive	Në %
2022-2023	2445	16.0%
2023-2024	2369	15.8%



Klasat kolektive përkufizohen si mjedise mësimore ku mësojnë njëkohësisht nxënës të niveleve të ndryshme arsimore nën drejtimin e një mësuesi të vetëm. Ato përfaqësojnë ende një sfidë të trashëguar, në zonat me dendësi të ulët popullore, pozicione të vështira gjeografike dhe prani të fragmentuar të institucioneve arsimore. Të dhënat tregojnë një prirje të qëndrueshme në drejtim të uljes së numrit absolut të klasave kolektive. Kjo ulje shfaqet gjithashtu edhe në përqindjen që klasat kolektive zënë ndaj totalit të klasave përkatëse në çdo vit shkollor. Ulja e klasave kolektive lidhet me disa faktorë si:

- Riorganizimi i rrjetit shkollor, nga ku janë ndërmarrë masa që kanë synuar riorganizimin apo bashkimin e shkollave me numër të ulët nxënësish.
- Zhvillimi dhe subvencionimi i transportit shkollor, që ka bërë të mundur transferimin e nxënësve drejt shkollave më të mëdha me kushte më të mira infrastrukturore dhe staf më të kualifikuar.
- Rritja e ndërgjegjësimit institucional, nga drejtuesit vendorë të arsimit dhe njësitë e qeverisjes vendore, lidhur me ndikimin që klasat kolektive mund të kenë mbi cilësinë e të nxënësve, veçanërisht në arsimin bazë.

Tabela 10. Të dhëna për raportin nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në arsimin bazë

Raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë - arsimi bazë		
Viti	Raporti nxënës/mësues	Raporti nxënës/klasë
2021-2022	11.9	19.9
2022-2023	11.3	19.3
2023-2024	11.0	19.0

Tabela 11. Të dhëna për raportin - nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në gjimnaz

Raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë - Gjimnaz		
Viti	Raporti nxënës/mësues	Raporti nxënës/klasë
2021-2022	13.5	26.8
2022-2023	12.8	25.9
2023-2024	11.58	23.6

Analiza e të dhënave statistikore në arsimin parauniversitar, evidenton një tendencë të qëndrueshme në ulje të raportit nxënës/mësues si dhe nxënës/klasë. Të dhënat tregojnë një ulje të këtyre treguesve, çka përbën një zhvillim pozitiv në kontekstin e përpjekjeve për përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor. Ulja e raportit nxënës/mësues krijon një mjedis të favorshëm për ndërveprim më të ngushtë pedagogjik, duke mundësuar individualizimin e procesit mësimor, identifikimin më të shpejtë të nevojave të veçanta të nxënësve dhe rritjen e efektivitetit.

Po ashtu, reduktimi i raportit nxënës/klasë përmirëson ndjeshëm parametrat fizikë dhe organizativë të të mësuarit, duke kontribuar në rritjen e përqendrimit, pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirjes në procesin edukativo-arsimor. Në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë, këto përmirësime ndikojnë drejtpërdrejt në fuqizimin e kapaciteteve të shkollave për të adresuar në mënyrë efektive kërkesat në rritje për cilësi, gjithëpërfshirje dhe eficiencë në arsim. Kjo tendencë është gjithashtu, në përputhje me objektivat strategjike të reformës në arsim dhe me standardet e përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare për cilësinë e arsimit bazë dhe të mesëm.

Tabela 12. Nxënës rom dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, 2023-2024

Nxënës rom	Total	Publik	Privat
Institucionet arsimore	3904	3858	46
Kopshte	596	580	16
Arsimi bazë	3184	3157	27
Arsimi fillor	2115	2096	19
Arsimi i mesëm i ulët	1069	1061	8
AML + Gjimnaze të orientuara	124	121	3
Nxënës egjiptian	Total	Publik	Privat
Institucionet arsimore	8604	8445	159
Kopshte	1551	1506	45
Arsimi bazë	6319	6222	97
Arsimi fillor	3531	3487	44
Arsimi i mesëm i ulët	2788	2735	53
AML + Gjimnaze te orientuara	734	717	17

Arsimi përbën një të drejtë themelore të njeriut dhe një instrument kyç për fuqizimin individual dhe zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror. Në këtë kuadër, garantimi i aksesit të barabartë dhe pjesëmarrjes efektive në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes etnike, sociale apo ekonomike, përfaqëson një nga objektivat themelore të politikave arsimore në Shqipëri. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshur, si dhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nxënësit me përkatësi rome dhe egjiptiane trajtohen në mënyrë të barabartë me të gjithë nxënësit e tjerë në të gjitha nivelet e arsimit bazë dhe të mesëm. Sipas të dhënave të raportuara nga strukturat arsimore, në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar janë aktualisht të përfshirë:

- 3904 nxënës me përkatësi rome
- 8604 nxënës me përkatësi egjiptiane

Ky tregues i rëndësishëm dëshmon përpjekjet institucionale dhe ndërsektoriale për të rritur nivelin e përfshirjes së komuniteteve të marginalizuara, duke e konsideruar arsimin si mjetin më të fuqishëm për thyerjen e ciklit të përjashtimit social dhe përmirësimin e mundësive për zhvillim personal e profesional.

Përkundër progresit të bërë në aspektin sasior të përfshirjes, mbetet e domosdoshme që kjo dinamikë të shoqërohet me masa gjithëpërfshirëse dhe të diferencuara, të cilat adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë faktorët që ndikojnë negativisht në vijueshmërinë dhe performancën shkollore të këtyre nxënësve. Këto masa përfshijnë:

- Përdorimin e metodologjive të mësimdhënies që marrin në konsideratë diversitetin kulturor dhe gjuhësor të nxënësve.
- Krijimin e mekanizmave mbështetës psiko-socialë për fëmijët dhe familjet e tyre.
- Zbatimin e programeve kompensuese për reduktimin e diferencave në arritje.

- Monitorimin sistematik të treguesve të përjashtimit të fshehur, si niveli i braktisjes, mungesat e zgjatura apo përfshirja formale pa angazhim real.

Tabela 13. Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social, 2023-2024

Psikologë dhe punonjës socialë 2023 - 2024	Total	Psikologë	Punonjës socialë
Institucionet arsimore	1323	864	459
Kopshte	323	213	110
Arsimi Bazë	686	425	261
Arsimi i Mesëm	314	226	88

Në vijimësi të reformave dhe politikave të ndërmarra në fushën e arsimit dhe mirëqenies së fëmijëve, vihet re një rritje e qëndrueshme e numrit të profesionistëve të shërbimeve psiko-sociale, konkretisht e psikologëve dhe punonjësve socialë, të cilët janë integruar në strukturat e institucioneve arsimore parauniversitare në të gjithë vendin. Kjo tendencë në rritje reflekton angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të garantuar një mjedis shkollor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe mbështetës për çdo nxënës, duke i kushtuar rëndësi jo vetëm dimensionit akademik të edukimit, por edhe zhvillimit emocional, social dhe psiko-fizik të fëmijëve dhe të rinjve. Përfshirja e këtyre profesionistëve në institucionet arsimore përbën një hallkë thelbësore në funksion të parandalimit të dukurive negative si bullizmi, dhuna në shkollë, braktisja shkollore, si dhe në adresimin në kohë të vështirësive që mund të hasin nxënësit në raport me mësimin, familjen apo komunitetin. Ky zhvillim është një dëshmi konkrete e rikonceptimit të rolit të shkollës si një mjedis gjithëpërfshirës që kontribuon në formimin e plotë dhe të shëndetshëm të personalitetit të fëmijës, në përputhje me parimet e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe me standardet e Bashkimit Evropian për arsimin dhe kujdesin ndaj fëmijëve.

2.4. PËRMIRËSIME NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

2.4.1. Risitë dhe përmirësimet në sistemin arsimor gjatë vitit 2024

- Lidhur me politikat e arsimit parauniversitar, bazuar në Planin e Veprimit të SKA 2021-2026, vihen re përmirësimet si më poshtë:
- Niveli i lartë i përfshirjes në arsimin parashkollor për moshën 5-6 vjeç (93.72%).
- Reduktimi i numrit të klasave kolektive, për të garantuar mundësi të barabarta për arsim cilësor për të gjithë nxënësit.
- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar ka patur progres të vazhdueshëm. Për vitin shkollor 2023-2024 numri i nxënësve me aftësi të kufizuara, të integruar në kopshte dhe shkolla normale është rritur krahasuar me vitin shkollor 2022-2023. Numri i mësuesve ndihmës në vitin 2024 në arsimin publik dhe privat është 2187 gjithsej nga të cilët, 1950 janë në arsimin publik.
- Ngritja e Qendrave Burimore për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe për nxënësit që nuk shikojnë, në zbatim të VKM nr. 148, datë 13.03.2024 “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre” dhe urdhrave në zbatim të këtij vendimi.
- Numri i punonjësve psiko-socialë në institucionet arsimore publike dhe private është rritur ndjeshëm. Për vitin shkollor 2024-2025 rezulton me 20% më shumë, krahasuar në vitin shkollor 2022-2023. Shkollat kanë përmirësuar infrastrukturën për shërbimin psiko-social, me mbi 595 kabinete të funksionalizuara. Trajnimet e vazhdueshme për punonjësit psiko-socialë, kanë përmirësuar dukshëm aftësitë për identifikimin dhe parandalimin e problemeve të shëndetit mendor.
- Sistemi për parandalimin dhe raportimin e dhunës dhe ekstremizmit është përmirësuar përmes rrjetit të mësuesve koordinatorë dhe ekipeve të përbëra nga mësues, nxënës dhe prindër.
- Rritja e pagave për mësuesit në vitin 2024 ka qenë një hap pozitiv për përmirësimin e statusit të profesionit.
- Skema e re e kualifikimit të mësuesve përbën një risi për arsimin parauniversitar, duke ofruar një proces kualifikimi më të shpejtë, më transparent dhe të bazuar në meritokraci. Mësuesit mund të përfitojnë gradat e kualifikimit në vitin e 3-të, të 8-të dhe të 15-të të punës së tyre, përmes një sistemi që vlerëson njohuritë, përvojën dhe aftësitë e tyre profesionale. Përveç faktit që kualifikimi merret më shpejt dhe trajnimet janë falas, mbështetja financiare për mësuesit është rritur ndjeshëm. Është dyfishuar shpërblimi për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”, ndërsa për “Mësuesin mjeshtër” rritja është prej 50%.
- Përmirësimi i programeve të formimit fillestar për mësuesit mbetet një prioritet, duke pasur parasysh ndikimin e tyre në cilësinë e arsimit.
- Zhvillimi profesional i mësuesve ka përparime të rëndësishme. Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional 2024-2025 në bashkëpunim me 7 universitetet publike që formojnë mësues përfaqëson një hap të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së trajnimeve. Në këtë kuadër deri në fund të vitit 2024 janë trajnuar gjithsej 16045 mësues për përdorimin e

metodave inovative në mësimdhënie. Gjithashtu janë trajnuar edhe 450 drejtues rrjetesh, lidhur me udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve në PISA.

- Infrastruktura TIK në arsimin parauniversitar tregon përparime dhe sfida të konsiderueshme në arritjen e objektivave për vitin 2026. Në kuadër të procesit të digjitalizimit të sistemit arsimor parauniversitar, janë ndërtuar deri tani 100 SmartLabs nga projekti Element IT, me mbështetjen e Fondit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AAFD), dhe 216 SmartLabs nga projekti GovTech i financuar nga Banka Botërore (BB). Me mbështetjen e Bankës Qendrore Europiane (BQE) do të ndërtohen edhe 645 SmartLabs të tjera. Qëllimi kryesor i përdorimit të SmartLabs është të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke integruar teknologjitë e reja në kurrikulën shkollore. Referuar statistikave në sistemin SMIP, programi kombëtar i kodimit (codemonkey) për vitin shkollor 2024-2025, është zbatuar gjithsej në 352 shkolla
- Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) ka treguar progres të dukshëm dhe vlerësohet si një nga sistemet më të avancuara në rajon. Ai siguron akses në kohë reale për nxënësit, prindërit dhe institucionet arsimore, mbi ecurinë dhe performancën e nxënësve. MAS-i ka miratuar rregulloren për përdorimin dhe funksionimin e plotë të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP). Kjo rregullore ka finalizuar të gjitha rolet e institucioneve si MAS, ASCAP, QSHA dhe DPAP për funksionimin korrekt të këtij sistemi. Shtimi i funksionaliteteve dhe shërbimeve vijon të pasurohet më tej si psh. Fleta informuese për prindërit, e cila informon në kohë reale prindërit për ecurinë e fëmijës dhe ndikon në këshillimin e karrierës për ta.

2.4.1.1. Rolet e reja të mësuesit në shkollë: mësuesi koordinator i orientimit për karrierë dhe mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë

Dy rolet e reja u jetësuan duke përzgjedhur 640 mësues koordinatorë të vlerësimit të cilësisë së shkollës dhe koordinatorë të karrierës në të gjithë sistemin tonë arsimor. Mësuesi koordinator i karrierës, është një rol kyç në ndihmën për nxënësit që të bëjnë zgjedhje të informuara për të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale. Këta mësues punojnë ngushtësisht me nxënësit, prindërit dhe stafin mësimor për t'i orientuar drejt arsimit të mesëm të përgjithshëm apo atij profesional, bazuar në prirjet dhe aftësitë e tyre. Janë 320 mësues të përfshirë në rolin e koordinatorit të karrierës, duke siguruar cilësi dhe gjithë përfshirje në orientimin e nxënësve. Nga ana tjetër 320 mësues koordinatorë të cilësisë, kanë për detyrë të sigurojnë që shkollat të ruajnë dhe të përmirësojnë standardet e tyre të performancës. Ata ndihmojnë mësuesit në zhvillimin profesional dhe në garantimin e cilësisë së mësimdhënies, duke u shndërruar në mentorë për ta.

Kriteret e për mësues koordinator i orientimit për karrierë janë:

- Të ketë 5 vite punë si mësues, ndër të cilat 3 vite në shkollën ku punon.
- Të ketë kategorinë “Mësues i kualifikuar” me rezultat “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”. Avanazh përbën rezultati “Shkëlqyeshëm”.
- Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësim “Shumë mirë” për dy vite rradhazi.

- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve, të cituara në vlerësimet periodike të mësuesit në shkollë apo certifikata në trajnime.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

Gjatë vitit 2024 janë trajnuar nga ASCAP rreth 147 koordinatorë të sigurimit të cilësisë lidhur me rëndësinë e rolit të tij në shkollë; me përgjegjësitë dhe pritshmëritë kryesore të punës së tij në shkollë; me parimet kryesore etike dhe profesionale të punës së koordinatorit të këshillimit të karrierës në AMU dhe në AML; me llojet kryesore të veprimtarive të këshillimit të karrierës, për nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe nxënësit në arsimin e mesëm të lartë; me parimet kryesore të planifikimit të veprimtarive të këshillimit të karrierës; me planin vjetor, kalendarin vjetor të veprimtarive të këshillimit të karrierës; me modele të planifikimit dhe të zhvillimit të veprimtarive të këshillimit të karrierës me nxënësit në AMU dhe në AML.

Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë

Krijimi i rolit të ri të mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë ka si qëllim të mbështesë stafin drejtues të shkollës në realizimin e vizionit të shkollës, në zhvillimin profesional të stafit të shkollës në përmirësimin e arritjeve të nxënësve, në vetëvlerësimin e shkollës, në ndërmarrjen e nismave për përmirësimin e cilësisë së ofruar në shkollë. Ai mund të kryejë kërkime, të analizojë të dhëna dhe të ndihmojë vendimmarrjen, duke u bazuar në rezultate. Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë ndihmon në aplikimin dhe menaxhimin e projekteve që mund të ketë shkolla. Ai gjithashtu mund të bashkëpunojë me partnerë të jashtëm ose me palë të interesuara për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e projekteve.

Kriteret për mësues koordinator për sigurimin e cilësisë janë:

- Të ketë 8 vite punë si mësues, ndër të cilat 5 vite në shkollën ku punon;
- Të ketë kategorinë “Mësues specialist” me rezultat “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”. Avanzh përbën rezultati “Shkëlqyeshëm”;
- Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësim “Shumë mirë” për tri vite rradhazi;
- Të ketë kryer prezantimin e një projekti novator për zhvillimin e lëndës që dëshmohet nga institucioni arsimor përkatës;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

Gjatë vitit 2024 janë trajnuar nga ASCAP rreth 240 koordinatorë të sigurimit të cilësisë, lidhur me rëndësinë e rolit të mësuesit koordinator të sigurimin e cilësisë në shkollë; rolet, përgjegjësitë dhe pritshmëritë kryesore të punës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë në shkollë; me tri dimensionet për sigurimin e cilësisë në shkollë, si dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e procesit mësimor dhe të rezultateve të nxënësve; me planifikimin e kohës së punës, që do e ndihmojë atë të menaxhojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mënyrë efektive; me hartimin e planin vjetor: me analizën e arritjeve të nxënësve etj.

2.4.1.2. Arsimi gjithëpërfshirës

Akresi në arsimin cilësor për romët dhe egjiptianët, grupet e marginalizuara ose të pafavorizuara dhe studentët me nevoja të veçanta.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë në vazhdimësi masa për lehtësimin dhe rritjen e frekuentimit të shkollës nga nxënësit, përfshirë ata romë dhe egjiptianë, si:

- pajisja me tekstet shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe për 16 kategori në nevojë në arsimin e mesëm të lartë;
- transporti falas për nxënësit që udhetojnë mbi dy kilometra për në shkollë;
- ofrimi i bursave edhe në arsimin bazë për nxënësit braktisës apo në rrezik braktisjeje;
- përmirësimi i infrastrukturës së shkollave, pajisja e shkollave me laboratorë për lëndë e fusha të nxëni;
- futja në sistem e mësuesve ndihmës dhe e mediatorëve;
- përmirësimi i shërbimit psiko-social;
- zbatimi i programeve të veçanta pas mësimit dhe i nismave “Shkolla qendër komunitare”, “Bëjmë detyrat në shkollë”, Art zeje dhe Sport etj.;
- MAS-i ka ndërmarrë rishikimin dhe përditësimin e kurrikulës, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit për të gjithë nxënësit.

ASCAP- i po harton modulën e veçantë për historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve. MAS-i ka miratuar Kornizën Kurrikulare të përditësuar. Në vijim të përgatitjes së dokumenteve të tjera që bazohen në këtë kornizë, do të shihet me përparësi dhe mundësia e përfshirjes së trashëgimisë kulturore dhe historisë romë në kurrikula.

- Raporti i nxënëve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special është përmirësuar nga viti në vit. Numri në rritje i nxënëve që frekuentojnë shkollat speciale, në krahasim me numrin e nxënëve që frekuentojnë arsimin e zakonshëm tregon qartazi edhe tendencën që kanë prindërit për të integruar fëmijët e kësaj kategorie në arsimin gjithëpërfshirës.
- Mbështetja e nxënëve me aftësi të kufizuara me mësues ndihmës vijon si prioritet. Në vitin 2023-2024 ishin të punësuar në sistemin e arsimit parauniversitar publik 1950 mësues ndihmës kundrejt 2266 mësuesve ndihmës të vitit 2024-2025.
- Rritja e numrit të mësuesve ndihmës ka sjellë një përmirësim të ndjeshëm të raportit mes nxënëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesve ndihmës. Mesatarisht, një mësues ndihmës punon me jo më shumë se 2 nxënës me aftësi të kufizuara. Edhe trajnimi i mësuesve ndihmës vijon të mbështetet vit pas viti me një buxhet të veçantë. Puna për këta mësues fillon me krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Janë krijuar rreth 60 rrjete profesionale, ku janë përfshirë mësues ndihmës në të gjithë vendin. Janë trajnuar drejtuesit e rrjeteve profesionale dhe është përgatitur një paketë e posaçme trajnimi për mësuesit ndihmës, e cila është e aksesueshme për çdo mësues ndihmës.
- Nxënësit me AK në arsimin parauniversitar vlerësohen për nivelin e paaftësisë dhe nevojat e tyre arsimore nga Komisionet Multidisiplinare (KMD) që ngrihen dhe funksionojnë pranë çdo ZVAP. KMD përcakton nëse nxënësi do të punojë me kurrikulën e zakonshme apo me kurrikul të përshtatur për nevojat e tij të veçanta, përmes Planit Edukativ Individual (PEI).

- Duke filluar nga viti shkollor 2023-2024, nxënësit me AK që kanë punuar me kurrikul të përshtatur, përmes PEI kanë mundësi të zgjedhin test të veçantë në provimet e Maturës Shtetërore, në provimet kombëtare të arsimit bazë, si dhe në vlerësimin e arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Prindi i nxënësit me AK, në momentin kur shkolla përgatit listën e nxënësve që do t'i nështrohen provimeve kombëtare, shprehet me shkrim nëse nxënësi do t'i nështrohet testit të veçantë, i cili vlerëson nivelin e arritjeve të nxënësit që punon me PEI.
- Me hyrjen në fuqi të VKM nr.148, datë 13.03.2024 “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special nv qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre” dhe urdhrave nr: 448, 449 dhe 450, datë 26.08.2024 “Për miratimin e riorganizimit të institucioneve të arsimit special në qendra burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës”, institucionet e arsimit special, “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Instituti i nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” funksionojnë si qendra burimore për nxënësit me AK.
- Kthimi i shkollave speciale në qendra burimore, duke i pajisur me kapacitetet e nevojshme profesionale edhe me instrumentet apo mjetet e nevojshme për zhvillimin dhe integrimin e tyre në arsimin gjithëpërfshirës do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e shërbimit arsimor që ato do të marrin në shkollat e zakonshme.

Qendrat burimore përveç arsimit special dhe shërbimeve të specializura që ofrojnë në mjediset e qendrës, mbështesin arsimimin e vazhduar të personave me aftësi të kufizuar edhe në institucione të tjera arsimore të niveleve të ndryshme. Këtë vit QB për nxënësit që nuk dëgjojnë

2.4.1.3. Përparimi/Planet mbi transformimin digjital të arsimit dhe trajnimeve

Në kuadër të ratifikimit të ligjit Nr. 45, datë 22.06.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim” për programin GovTech, janë përzgjedhur edhe 200 shkolla të tjera, të cilat janë pajisur me 216 SmartLab-e, për zhvillimin e lëndës së TIK-ut, me synim integrimin e saj edhe në lëndë të tjera.

Në kuadër të Ligjit nr. 121/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për financimin e projektit “Laboratorët Inteligjentë (*Smart labs*) - digjitalizimi i sistemit arsimor shqiptar” do të bëhet:

Instalimi i Smart Labs në mbi 600 shkolla publike të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, si dhe në 25 shkolla me klasa kolektive.

Ngritja e kapaciteteve duke përditësuar kurrikulën e TIK-ut, trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve për lëndën e TIK-ut, si dhe sigurimin e materialeve mbështetëse për mësuesit dhe nxënësit

Për zhvillimin e ekosistemit të arsimit digjital, shkollat e arsimit parauniversitar përdorin platformën SMIP, e cila është një databazë shtetërore për menaxhimin e informacionit të arsimit parauniversitar në kohë reale, si dhe mundëson shërbime për informimin e prindërve mbi progresin e fëmijëve.

Në bashkëpunim me AADF dhe Intel Cooperation Inc., po zhvillohet programi inovativ që do të aftësojë nxënësit e moshave 13-19 vjeç në fushën e inteligjencës artificiale (IA). Aktualisht pjesë e projektit janë 31 shkolla të arsimit të mesëm të lartë.

AADF ka ndërtuar laboratorët e Inteligjencës Artificiale në institucionet publike të arsimit të mesëm të lartë. Çdo shkollë ka një grup prej 20 nxënësish, të cilët do të zhvillojnë kurrikulën e projektit për 1-2 vite. Për zbatimin e projektit “Inteligjenca Artificiale për të Rinjtë” deri më tani janë trajnuar 50 mësues dhe janë bërë pjesë e projektit mbi 1400 nxënës. Parashikohet që deri në vitin 2027 përfitues të jenë rreth 2000 nxënës dhe 140 mësues.

2.4.1.4. Projekti GOVTECH me Bankën Botërore

Sistemi arsimor parauniversitar ka 1725 institucione publike të pajisura me lidhje interneti dhe në 200 prej tyre ka edhe wireless.

Në kuadër të projektit të Bankës Botërore GovTech “Përmirësimi i Qasjes së Barabartë në Shërbimet Publike me Standard të Lartë përmes GovTech”, bazuar në aktin e miratimit datë 01.12.2023 e grupit të përbashkët të ngritur në bazë të Urdhrit nr. 1 datë 19.10.2023 “Për ngritjen e Grupit të Përbashkët të Punës për Implementimin e Laboratorëve Smart” për miratimin e “Planit të Implementimit dhe Monitorimit të Performancës për Laboratorët Smart 2023-2025”, ASCAP-i ka kontraktuar Universitetin e Tiranës për realizimin e aktiviteteve të planit të implementimit. Në këtë kuadër janë hartuar dokumentet dhe janë realizuar veprimtaritë si më poshtë:

- Trajnimi me 200 drejtues të shkollave që kanë SmartLab-eve.
- Kornizë për vijimin e ZHVP së drejtorëve lidhur me përdorimin e SmartLab në procesin mësimor edhe në lëndët e tjera.
- Hartimi i dy moduleve për punonjësit e zyrave arsimore lidhur me përdorimin e SmartLab-ve në procesin mësimor.
- Trajnimi i 52 koordinatorëve digjitalë lidhur me përdorimin e SmartLab në procesin mësimor.
- Dy manuale metodologjike për vlerësimin e aritjeve të nxënësve në klasën e parë dhe të dytë me pre-test, post-teste për rezultatet e nxënësve nga zbatimi i kurrikulës së TIK.
- Hartimi i dy instrumenteve pre -test për lëndën e TIK në klasën e parë dhe të klasës së dytë
- Realizimi i vlerësimit të rreth 5000 nxënësve që kanë mbaruar klasën e parë në vitin shkollor 2023-2024 me post-test.
- Analiza e aftësive matematikore që realizohen nëpërmjet aftësive digjitale për nxënësit në klasat 1-3.
- Kryerja e vlerësimit të 400 mësuesve të AF, për nivelin e kompetetencës digjitale bazuar në standardet profesionale të përdorimit të TIK.
- Organizimi i trajnimit të mësuesve të arsimit fillor për aftësitë bazë të mësuesve bazuar në standardet profesionale të përdorimit të TIK.
- Dokument metodologjik për shtrirjen e trajnimeve në mënyrë të vazhduar të mësuesve të AF lidhur me përdorimin e aftësive digjitale bazuar në standardet profesionale të përdorimit të TIK.
- Trajnimi i organizuar me 200 mësues të TIK për sigurinë kibernetike.
- Monitorimi i 200 shkollave për zbatimin e kurrikulës së TIK në klasë të parë në 200 laboratorët SMART.

Janë ndërtuar 216 SmartLabs nga projekti GovTech i financuar nga Banka Botërore (BB) dhe 6 Smartlabs nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA). Në kuadër të Ligjit nr. 121/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe

Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për financimin e projektit “Laboratorët Inteligjentë (*Smart labs*) – digjitalizimi i sistemit arsimor shqiptar” do të bëhet instalimi i Smart Labs në mbi 600 shkolla publike të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, si dhe në 25 shkolla me klasa kolektive. Qëllimi i përdorimit të SmartLabs është të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke integruar teknologjitë e reja në kurrikulën shkollore.

2.4.2. Aktet rregullatore të miratuara/ përditësuara

- Kuadri rregullator ka përcaktuar nivelet e diplomave për mësuesit e arsimit parauniversitar.
- Janë hartuar standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor për mësuesit në sistemin e arsimit parauniversitar.
- Është krijuar portali i trajnimit të mësuesve, me prioritet aftësimi i tyre për kompetencën digjitale.
- Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit, testin për profilin/ lëndën përkatëse dhe ora e hapur ose projekti kurrikular.
- Lidhur me ndërtimin e një sistemi të ri të ngritjes në karrierë të bazuar në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë, gjatë vitit 2024 MAS-i ka hartuar:
 - a) Kornizën e karrierës së profesionit të mësuesit në Republikën e Shqipërisë, ASCAP.
 - b) Udhëzimin nr. 16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, MAS.
 - c) Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”, MAS.
 - d) Urdhrin nr. 157, datë 23.9.2024 “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat dhe kriteret e akreditimit dhe njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësve arsimorë”.
 - e) Urdhrin për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit Koordinator për sigurimin e cilësisë” dhe të “Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, MAS.
 - f) Udhëzuesin për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë, ASCAP 2024.
 - g) Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në arsimin e mesëm të ulët, ASCAP 2024.
 - h) Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në arsimin e mesëm të lartë, ASCAP 2024.
 - i) Udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve.
- Është hartuar dokumenti për kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit bazuar në standardet profesionale të mësuesit.
- Janë hartuar standardet e performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave.
- Janë hartuar standardet profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.
- VKM nr. 148, datë 13.03.2024 “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre”.

- Urdhri nr.448, datë 26.08.2024, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e riorganizimit të institucionit të arsimit special “Luigj Gurakuqi” në Qendër Burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës”.
- Urdhri nr. 449, datë 26.08.2024, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e riorganizimit të Institutit të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, në Qendër Burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës”.
- Urdhri nr.450 datë 26.08.2024, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e riorganizimit të Institutit të Nxënësve që Nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi”, në Qendër Burimore emërtesës, strukturës dhe organikës”.

2.4.3. Paketa kurrikulare për arsimin parauniversitar

Gjatë vitit 2024, sistemi i zhvillimit profesional të mësuesve ka pësuar ndryshime. Në këtë kuadër janë hartuar disa materiale, udhëzime, udhëzues si më poshtë:

Paketa kurrikulare për arsimin parauniversitar, për kurrikulën me bazë kompetencat, përfshin:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.
- Kurrikulën bërthamë për nivelet 0-3:
 - a) klasa përgatitore dhe arsimit fillor (I-V);
 - b) arsimit i mesëm i ulët (VI-IX),
 - c) arsimit i mesëm i lartë (X-XII).
- Kornizën e vlerësimit të nxënësve, përfshirë nivelet e arritjeve të nxënësve për çdo shkallë të kurrikulës dhe fushë të nxëni/lëndë mësimore.
- Planin mësimor të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm si dhe planet mësimore për shkolla të veçanta (për klasat e shansit të dytë, për fëmijët e ngujuar, për shkollat speciale, për arsimin bazë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, për arsimin bazë me kohë të pjesshme, për pakicat kombëtare).
- Programe lëndore, të përgatitura për klasat dhe lëndët e arsimit bazë dhe lëndët e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të arsimit të mesëm.
- Programet orientuese të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (VANAF), të provimeve kombëtare të arsimit bazë (PKAB) dhe të maturës shtetërore (MSH).
- Udhëzime të Ministrisë përgjegjëse për arsimin për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat dhe udhëzues kurrikularë të përgjithshëm dhe lëndorë, për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.
- Udhëzuesit për përgatitjen e nxënësve për vlerësimin ndërkombëtar PISA, në lëndët Kimi, biologji, fizikë dhe matematikë.

2.5. REZULTATET E NXËNËSVE NË TESTET NDËRKOMBËTARE

2.5.1. Rezultatet në testin TIMSS

Shqipëria renditet në listën e 14 shteteve me rezultate në rritje në Matematikë dhe në listën e 15 shteteve me rezultate në rritje në Shkencë. Rezultatet e TIMSS 2023 arritur nga nxënësit shqiptarë (publikuar në fund të vitit 2024), janë inkurajuese në rrugën për transformimin e arsimit dhe afrimin me standardet më të mira ndërkombëtare. Studimi Ndërkombëtar i Prirjeve në Matematikë dhe Shkencë (TIMSS) është një vlerësim ndërkombëtar, që realizohet një herë në katër vjet, i organizuar nga Organizata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Arritjeve Arsimore (IEA).

2.5.2. TALIS 2024

Në kuadër të përfshirjes së Shqipërisë për herë të parë në studimin ndërkombëtar “Teaching And Learning Internaional Survey” TALIS 2024, ASCAP-i ndoqi me prioritet veprimtaritë dhe aktivitetet, me qëllim realizimin me sukses të këtij procesi. Shqipëria mori pjesë në studimin kryesor, i cili i përket nivelit ISCED 2 (Arsim i Mesëm i Ulët), mësues dhe drejtues të klasave 6-9, në të tre fazat e aplikimit të saj, të cilat janë:

1. Faza e pilotimit të instrumenteve (Janar 2022-Maj 2022)
2. Faza e pilotimit (Maj 2022-Mars 2023)
3. Faza e studimit kryesor (Prill 2023-Maj 2024)

Në fazën e studimit kryesor, janë përzgjedhur 282 shkolla, 282 drejtues të institucioneve arsimore dhe 4056 mësues të Arsimit të Mesëm të Ulët. Administrimi i pyetësorit u realizua përgjatë periudhës Mars-Prill 2024. Pyetësori u zhvillua në 282 shkolla të përzgjedhura, ku morën pjesë 282 drejtues shkollash dhe 4056 mësues pjesëmarrës. ASCAP-i vijon të jetë në kontakt të vazhdueshëm me grupin koordinues të TALIS 2024 për çdo informacion të ri lidhur me rezultatet e studimit kryesor “Main Survey, 2024”.

2.5.3. Rezultatet në vlerësimin ndërkombëtar PISA

Shqipëria merr pjesë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) që nga viti 2000.

Tabela 15. Rezultatet e nxënësve shqiptarë në 3 pjesëmarrjet e fundit, krahasuar me mesataren e OECD-së

Fusha	2015		2018		2022	
	AL	OECD	AL	OECD	AL	OECD
Lexim	405	493	405	487	368	471
Matematikë	413	490	437	489	358	476
Shkenca	427	493	417	489	376	485

Rënia e rezultateve të PISA 2022 në krahasim me PISA 2018 është ndikuar nga disa faktorë si:

- Në nëntor të vitit 2019, vendi ynë u godit nga një tërmet që shkaktoi shumë dëme infrastrukturore, përfshirë shkolla dhe banesa.
- Më shumë se gjysma e nxënësve të përzgjedhur për të marrë pjesë në PISA 2022 (50.5%) ishin nxënës nga qytetet më të prekura nga tërmeti i nëntorit.
- Pjesa më e madhe e nxënësve, deri në muajin Prill kur u zhvillua vlerësimi PISA 2022, nuk kanë zhvilluar mësim në shkollat e tyre. Mësimi në këto shkolla u zhvillua me turne dhe orë mësimore të shkurtuara.
- Pandemia COVID - 19 që u shoqërua me mbyllje të shkollave dhe me mësimin online në të gjithë botën edhe në Shqipëri.
- Mësimdhënia hibride (digjitale dhe në prezencë).
- Vlerësimi PISA zhvillohet me kompjuter dhe për pyetjet e matematikës dhe të shkencave përdoren platforma interaktive, ku nxënësit nëpërmjet simulimeve zhvillojnë eksperimentet dhe më pas u përgjigjen pyetjeve. Këto lloj platformash nuk janë përdorur në zhvillimin e orëve mësimore në shkollat tona.

Nga çështjet kryesore që mund të adresohen lidhur me rezultatet në testin PISA, është përdorimi i teknologjisë, pasi ka shumë peshë në rezultatet e nxënësve. Në këtë kuadër, është vendosur në plan të parë përmirësimi i infrastrukturës digjitale në shkolla dhe trajnimi i mësuesve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Ky është një proces që kërkon kohë, trajnime dhe investime të vazhdueshme Megjithatë, mësuesit po e bëjnë pjesë të punës së tyre të përditshme përdorimin e teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies, në përmbushje të standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.

2.5.4. Masat e marra nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas analizimit dhe vlerësimit të situatës në funksion të përmirësimit të rezultateve të nxënësve në testet ndërkombëtare, ka marrë disa masa si më poshtë:

Nr	Masat	Institucioni përgjegjës
1	Hartimi i planit të veprimit me masat dhe urdhri për miratimin e tij	Koordinohet nga MAS
2	Përgatitja në shqip e kornizës së përmbajtjes së testimeve ndërkombëtare për secilën fushë të përmbajtjes (si program orientues), dhe vënia në dispozicion institucioneve përgjegjëse, ashtu siç është bërë për TIMSS.	QSHA
3	Raporti i testeve ndërkombëtare për vlerësimin e nxënësve të përkthyer të vënë në dispozicion të institucioneve pjesë e këtij plani veprimi.	QSHA
4	Hartimi i paketës së trajnimit me drejtuesit e rrjeteve profesionale dhe mësuesit e fushave lexim, matematikë dhe shkencë (fizikë, kimi, biologji) lidhur materialet mbështetëse të hartuara në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies në fushat që testohen në PISA.	ASCAP
5	Organizimi i trajnimeve dhe mentorimeve me drejtuesit e rrjeteve profesionale dhe mësuesit e fushave lexim, matematikë dhe shkencë (fizikë, kimi, biologji) lidhur materialet mbështetëse të hartuara në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies në fushat që testohen në PISA.	ASCAP
6	Hartimi i testeve të provimeve kombëtare të klasës V dhe të klasës IX sipas modeleve të pyetjeve që trajtohen në testimet ndërkombëtare.	QSHA
7	Pajisja e shkollave me internet për përdorimin e vazhdueshëm të teknologjisë nga mësuesit	MAS, AKAP
8	Ndërhyrje në programin fillestar të mësuesve për përgatitjen e tyre me filozofinë e testimeve ndërkombëtare, veçanërisht testimit PISA.	MAS, IAL
9	Sigurimi i mësimit të barabartë për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevojë të veçanta.	AKAP
10	Monitorimi i procesit mësimor në shkollë me fokus mësimdhënien dhe vlerësimin e nxënësve sipas formateve të testimeve ndërkombëtare, veçanërisht testimit PISA.	AKAP, ASCAP

3. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Vizioni i MAS i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, synon ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale.

3.1. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU 2024

Tabela e vlerësimit të performancës për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU				
PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR	Vizioni	Qëllimi i politikës	Vlerësimi Viti 2024	Vlerësimi Viti 2023
	Sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në BE.	Qëllimi i Politikës A Arsimi parauniversitar	4.35	3.73
		Qëllimi i Politikës B Menaxhim i sistemit të arsimit parauniversitar	4.51	4.37
	Vlerësimi i Performancës së SAPU-së		4.43 ↑	4.05

Gjatë vitit 2024, ka pasur progres lidhur realizimin e qëllimit të politikave arsimore të parashikuara në SKA 2021-2026. Procesi i vlerësimit të performancës së SAPU 2024 ka evidentuar përparim krahasuar me vitin 2023, në të gjitha nivelet e arsimit: në arsimin parashkollor dhe parapërgatitor, në arsimin bazë dhe të mesëm. Indeksi i vlerësimit të performancës së SAPU, nga 4.05 në vitin 2023, është rritur në 4.43 në vitin 2024. Performanca e sistemit ka bërë gjithashtu përparim të dukshëm lidhur me planifikimin, shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e donatorëve.